



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

KOMISIONI PËR PUNËN, ÇËSHTJET SOCIALE DHE SHËNDETËSINË

Tiranë, më 10. 11. 2021

Dokument parlamentar

(Komision për dhënie mendimi)

RAPORT

PËR PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT 2022” NË PARIM

Drejtuar: Komisionit përgjegjës për Ekonominë dhe Financat

I. Hyrje

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjet e datës 9 dhe 10 nëntor 2021, bëri prezantimin në parim të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2022”, të paraqitur nga Këshilli i Ministrave.

Në mbledhjen e komisionit morën pjesë Ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale znj. Ogerta Manastirliu, Zv. Ministrja e Financave dhe Ekonomisë, znj. Adela Xhemali, Ministrja Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, znj. Bora Muxhaqi, si dhe përfaqësues të tjerë të këtyre ministrive, të cilët bënë paraqitjen e projektbuxhetit për vitin 2022 para anëtarëve të Komisionit dhe iu përgjigjën pyetjeve në parim.

II. Baza kushtetuese e projektligjit, vlerësimi kushtetues dhe procedural

Propozimi i këtij projektligji vjen nga ana e Këshillit të Ministrave, në bazë të nenit 81, pika 1 të Kushtetutës.

Projektligji është bazuar në nenet 78, 83, pika 1, dhe 158 të Kushtetutës .

Projektligji për buxhetin i nënshtrohet një procedure të posaçme shqyrtimi, e cila është e parashikuar në Rregulloren e Kuvendit, në nenet 78-85 të saj.

III. Objektivat e Buxhetit 2022

Projektbuxheti ka në themel objektivat e kuadrit makroekonomik e fiskal afatmesëm për tri vitet në vijim për ruajtjen dhe konsolidimin e mëtejshëm të stabilitetit makroekonomik të vendit si dhe krijimin e klimës për një rritje të lartë e të qëndrueshme ekonomike. Projektbuxheti 2022 synon konsolidimin e rimëkëmbjes ekonomike të vendit pas dy fatkeqësive natyrore, si tërmeti i 26 nëntorit 2019 dhe pandemia e shkaktuar nga COVID-19. Njëkohësisht, nëpërmjet politikave fiskale të kujdesshme që do të ndërmerren si nga krahu i të ardhurave dhe atyre të shpenzimeve buxhetore, synohet të sigurohet një ulje e pandalshme dhe e qëndrueshme e stokut të borxhit publik në periudhën afatmesme 2022-2024.

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë e shqyrton këtë projektligj sipas fushës së saj të përgjegjësisë. Konkretisht komisioni do të trajtojë projekt-buxhetin e akorduar për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrinë e financave dhe ekonomisë për pjesën e Arsimit Profesional dhe marrëdhëniet e punës, si dhe Ministrinë e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët.

Prioritetet 2022-2024 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në sektorin e shëndetësisë do të jenë:

- Financimi i shërbimeve shëndetësore (parësore e spitalore);
- Qëndrueshmëria dhe përmirësimi i situatës financiare institucioneve shëndetësore e të mbrojtjes sociale, nëpërmjet përdorimit me efektivitet të burimeve të financimit, forcimit të kontrollit të shpenzimeve;
- Rritja e kosto-efektivitetit të listës së barnave e pajisjeve të rimbursueshme;
- Financimi i paketave të miratuara të shërbimit spitalor në spitalet publike e jopublike;
- Pagesat për kujdes shëndetësor, sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të nënshkruara;
- Intensifikimi i punës për kostimin e shërbimeve të reja shëndetësore, në kujdesin shëndetësor, me synim ndryshimin e mënyrës së financimit të shërbimeve shëndetësore;
- Financimi i shërbimit të kontrollit bazë mjekësor bazë për të paktën 50% të numrit të shtetasve të moshës 35-70 vjeç;
- Vaksinimi masiv i popullatës për Covid-19

Rezultatet që synohet të arrihen për periudhën afatmesme 2022-2024

- Mbulimi universal i popullsisë me shërbim shëndetësor duke parashikuar 6.4 milionë numër vizitash në periudhën 2022-2024, mbështetur në treguesit e sëmundshmërisë.
- Ofrimi i shërbimit të kontrollit bazë (check-up) për mesatarisht 475 mijë pacientë në vit;

- Trajtimi me recetë rimbursimi i mesatarisht 400 mijë pacientëve në vit, përgjatë periudhës 2022-2024.
- Numri i pacientëve të trajtuar mesatarisht 340 mijë pacientë në vit për periudhën 2022-2024;
- Rritja e numrit të pacientëve që përfitojnë nga paketat e kardiokirurgjisë dhe kardiologjisë (200 pacientë më shumë çdo vit, për periudhën 2022-2024);
- Numri i pacientëve përfitues nga shërbimi i dializës për vitin 2022 parashikohet rreth 1,500 pacientë, e çdo vit shtohen rreth 120 pacientë Mesatarisht çdo pacient kryen 13 seanca në muaj. Për periudhën 2022-2024 parashikohet rritje e ndjeshme e numrit seancave për pacientët që përfitojnë nga trajtimi me dializë nga 234 mijë seanca në vitin 2022, në 271 mijë në vitin 2024;
- Trajtimi i mesatarisht 25 fëmijëve në vit më Sindromën Doën përgjatë periudhës 2022-2024.
- Reduktimit të kohës aktuale prej 15 ditësh të pritjes për ekzaminime të rëndësishme (rezonancë magnetike, skaner etj.);
- Përmirësimi i mëtejshëm i koeficientit të shfrytëzimit të shtretërve më shumë se 48% që rezulton në vitin 2021.
- Mesatarisht 200 raste më shumë çdo vit gra të depistuar për kancerin e qafës së mitrës, përgjatë 2022-2024 me synim uljen e vdekshmërisë nga kanceri i qafës së mitrës nga 2.6/100 000 në vitin 2021 në 2.5/100 000 në vitin 2024.
- Rritja e numrit të thirrjeve të adresuara në njësitë e Urgjencës mjekësore nga 700 mijë thirrje në vitin 2021 në 800 mijë thirrje në vitin 2024, me një kohë reagimi mesatarisht prej 16 minutash.

Prioritetet 2022-2024 për Mbrojtjen Sociale

Në fushën e mbrojtjes sociale, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale synon zbatimin e reformës së programit të përkujdesit social në tre shtyllat kryesore të tij:

1. Ndihma Ekonomike,
2. Paftësia e Kufizuar dhe
3. Shërbimet Sociale.

Shpenzime të tjera sociale, përfshin fondet për pagesën e papunësisë, aftësisë së kufizuar, ndihmës ekonomike, dëmshpërblimin e ish-të përndjekurve politikë dhe bonusin e lindjeve.

- Shpenzimet për pagesën e papunësisë parashikohen në nivelin **900 milionë lekë**.
- Shpenzimet për pagesën e ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar parashikohen në nivelin **23.5 miliardë lekë** ose 1.3% e PBB.
- Për ish-të përndjekurit është parashikuar një fond prej **1 miliardë lekë** ose 0.1% e PBB-së.
- Për bonusin e lindjeve është parashikuar një fond prej **2.2 miliardë lekë** ose 0.1% e PBB-së.

Prioritetet 2022-2024 në lidhje me Arsimin profesional dhe punësimin:

Prioritetet dhe objektivat gjatë periudhës 2022-2024 që synohen në fushën e arsimit profesional dhe punësimit janë:

- Rritja e aksesit në Arsimin profesional;
- Sigurimi i cilësisë në AFP.

Projekt Buxheti për vitin 2022 - Programi i Arsimit të Mesëm Profesional

Politika e këtij programi synon të përmbushë qëllimin e Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi e 2019-2022 dhe planit të saj të veprimit, të identifikojë dhe hartojë politikat e duhura për punësimin, arsimin dhe formimin profesional, në mënyrë që të krijojë vende pune dhe mundësi cilësore për punësim dhe aftësi përgjatë gjithë ciklit të jetës

Programi synon zhvillimin e një sistemi të arsimit dhe formimit profesional, i cili garanton arsim dhe formim profesional cilësor dhe gjithëpërfshirës nëpërmjet:

- Sigurimit të një procesi mësimor cilësor e me kushte optimale të të nxënës, teorik e praktik për ti pajisur nxënësit me kompetencat e duhura;
- Ndërtimit, rikostruksionit dhe paisjes me laboratorë/makineri, të shkollave dhe reparteve të praktikave profesionale si një nga prioritetet dhe në programin e qeverisë Shqipëria 2030 për arsimin profesional;
- Rishikimit të programeve ekzistuese dhe hartimit të programeve të reja në përputhje me parimet e barazisë gjinore dhe gjithëpërfshirjes, në zbatim të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve;
- Hartimit dhe miratimit të standarteve të profesioneve dhe kualifikimeve sipas niveleve të KSHK;
- Zhvillimit të vazhdueshëm profesional të mësuesve si një nga shtyllat kryesore të sigurimit të cilësisë në arsimin profesional;
- Fillimit të implementimit të akreditimit të ofruesve të AFP-së;
- Funkcionimit të komitetit sektorial të TIK;
- Ngritjes dhe funksionimit të strukturës së Inspektimit të Arsimit Profesional;
- Modernizimit të kuadrit ligjor të AFP ekzistues, që rregullojnë sistemin e AFP-së, si dhe aspektet që kanë të bëjnë me AFP-në (hartimi i skeletkurrikulave, materialeve mësimore, trajnimi i mësuesve, etj.) në zbatim të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

Fondet e planifikuara për 2022 do investohen dhe në:

- Modernizimin e kuadrit ligjor të AFP-së ekzistues që rregullojnë sistemin e AFP-së, si dhe aspektet që kanë të bëjnë me AFP-në (hartimi i skeletkurrikulave, materialeve mësimore, trajnimin e mësuesve, etj);
- Rishikimin e programeve ekzistuese dhe hartimin e programeve të reja në përputhje me parimet e barazisë gjinore dhe gjithëpërfshirjes në zbatim të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, hartimin e standarteve të profesioneve dhe kualifikimeve sipas niveleve të KSHK;
- Zhvillimin e kompetencave të mësuesve dhe instruktoreve të AFP-së në përputhje me zhvillimet e reja teknologjike dhe forcimi i lidhjeve midis të nxënës dhe punës, fillimin e implementimit të akreditimit të ofruesve të AFP-së.

Fondi i planifikuar në lidhje me rininë

Nga fondi rezervë prej 3 400 milionë lekësh, i cili përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave, 500 milionë lekë do të përdoren për projektin për fëmijët dhe rininë.

Do të ketë gjithashtu mbështetje me investime për ristrukturimin, ndërtimin dhe pajisjen e objekteve për rininë në funksion të përmirësimit të kushteve për argëtim në shumën 50 milionë lekë.

IV. ÇËSHTJE TË DISKUTUARA LIDHUR ME PROJEKTBUXHETIN NË KOMISION

Gjatë prezantimit të projektbuxhetit në Komision, Ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale znj. Ogerta Manastirliu informoi deputetët se projektbuxheti 2022 mbështetet në shtyllat e programit qeverisës për shëndetësinë dhe mbrojtjen sociale, duke synuar mbulim shëndetësor universal, shërbime cilësore, mbrojtjen e shëndetit publik përmes vaksinimit anti Covid të popullatës dhe konsolidimin dhe rritjen e mburojës sociale për kategoritë në nevojë. Buxheti i shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale për vitin 2022 parashikohet 91,476,088 mijë lekë përkatësisht 63,63 miliard lekë janë të dedikuar për sektorin e shëndetësisë dhe 27,8 miliard lekë për programet e mbrojtjes sociale, me një rritje prej 6.9 % krahasuar me buxhetin fillestar 2021.

Zv. Ministrja e Financave dhe Ekonomisë, znj. Adela Xhemali Informoi deputetët se reforma për arsimin dhe formimin profesional është fokusuar në garantimin e cilësisë, duke siguruar parimet thelbësore të gjithëpërfshirjes dhe lidhjen me tregun e punës. Investimi në AFP është ndër investimet më eficiente me impakt të sigurtë dhe të drejtpërdrejtë në zhvillimin e biznesit dhe rritjen ekonomike të vendit pasi i përgjigjet mungesave për punonjës të kualifikuar, nxit produktivitetin dhe fitimet e kompanive, rigjallëron sektorët ekonomikë në rënie për shak të mungesave në aftësi dhe nxit investimet e huaja në vend.

Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2019 - 2022 është dokumenti kryesor i politikës që udhëzon zbatimin e veprimeve që lidhen me punësimin dhe zhvillimin e aftësive dhe orientimin në tregun punës e cila ka synim kryesor sigurimin e cilësisë së arsimint dhe formimit profesional.

Ministrja e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, znj. Bora Muzhaqi tha në fjalën e saj se ky institucion vjen si një Ministri Shteti e re, por me një fokus dhe buxhet të veçantë, për herë të parë për rininë dhe fëmijët. Në buxhetin e vitit 2022 për Ministrin e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, janë planifikuar 211, 370, 000 lekë, konkretisht në zërin 08610 të “Buxhetit 2022 sipas Ministrive të linjes dhe Institucioneve buxhetore.

Relatoret e maxhorancës të projektligjit për buxhetin: znj. Anila Denaj dhe znj. Mirela Pitushi, vlerësuan mbështetjen buxhetore për Shëndetësinë, mbrojtjen sociale, arsimin profesional, rininë dhe fëmijët, të cilat do kenë një impakt të ndjeshëm te qytetarët gjatë vitit të ardhshëm. Znj. Denaj theksoi se buxheti i shëndetësisë zë 4,89% në buxhetin e brendshëm bruto dhe është buxheti më i lartë në vitet e fundit. Me rritjen e këtij buxheti është bërë një hap cilësor drejt angazhimit për investime dhe për rritjen e vëmendjes ndaj shpenzimeve në këtë fushë të

rëndësishme. Znj Mirela Pitushi vlerësoi menaxhimin që iu bë dy fatkeqësive natyrore si tërmetit ashtu edhe pandemisë së shkaktuar nga COVID-19. Ajo vlerësoi shpenzimet për Ndihmën Ekonomike dhe Pagesën e Paaftësisë (PAK), mbështetjen e madhe financiare që iu është bërë shtresave në nevojë në drejtime të ndryshme, si dhe shpenzimet për bonusin e lindjeve.

Relatoret e opozitës të projektligjit për buxhetin: znj. Orjola Pampuri vlerësoi rritjen e buxhetit, por problematika në buxhetet e këtyre viteve ka qenë vendosja e prioriteteve. Një ndër prioritetet është vaksinimi dhe ne nuk jemi kundër tij, por duhet të jenë vaksina të miratuara nga FDA dhe EMA, kjo për të bërë të mundur ndërgjegjësimin e popullatës. Paketa e mbështetjes anticovid është një paketë shumë e varfër dhe kërkojmë që kjo paketë të ketë medikamente me kosto të lartë dhe me standarte të Bashkimit Europian. Gjithashtu prioritet është edhe check up, ndërkohë që prioritet duhet të jenë vështirësitë që ka sistemi shëndetësor. Znj. Grida Duma në fjalën e saj tha se arsimi profesional zë 3% të projektbuxhetit që është më i ulti në Ballkan e në rajon, për të mos folur për minimumin e Europës. Arsimi profesional në gjithë botën ka si bazë laboratore, teknologji të avancuar, praktika në punë, dhe kryqëzim strategjik, zëra të cilat në projektbuxhetin tonë nuk ekzistojnë. Për sa i përket skemës së ndihmës ekonomike, është një skemë, e cila ka nxjerrë jashtë saj një numër të konsiderueshëm familjesh në nevojë. Ne kemi kërkuar dhe kërkojmë transparencën për përjashtimin e këtyre familjeve dhe përtej kësaj akoma nuk kemi arritur në diskutime për minimumin jetik në të cilin jeton sot një familje shqiptare. Nuk dimë ende nëse kjo ndihmë ekonomike u jep mundësi familjeve në nevojë për të mbijetuar. Buxheti i planifikuar për rininë është një buxhet i padetajuar.

Në vazhdim të diskutimit në Komision, ministret përkatëse iu përgjigjën pyetjeve të deputetëve lidhur me parashikimet e buxhetit për shëndetësinë, mbrojtjen sociale, arsimin profesional, punën, rininë dhe fëmijët.

Nga kryetarja e komisionit u tërhoq vëmendja se materiali i ardhur nga Ministria e Shëndetësisë është material i vakët dhe jo shterues. Gjithashtu ngriti problematikën e largimit masiv të stafit të mjekëve dhe infermierëve nga Shqipëria për të ushtruar profesionin e tyre në Europë.

Nga kryetari i komisionit u tërhoq vëmendja se materiali i ardhur nga Ministria e Shëndetësisë është material i vakët dhe jo shterues. Gjithashtu ngriti problematikën e largimit masiv të stafit të mjekëve dhe infermierëve nga Shqipëria për të ushtruar profesionin e tyre në Europë. Ajo shpjegoi votën kundër buxhetit 2022, si një buxhet që nuk akomodon asnjë problematikë të evidentuar nga raportet e fundit të Bankës Botërore, Eurostat, Komisionit Europian apo KLSH. Buxheti 2022 është buxhet klientelist, që nuk mendon për qytetarët por për oligarkët. Me këtë buxhet Shqipëria do të vazhdojë të jetë në vendin e fundit në rajon dhe Europë në cdo tregues të shëndetësisë e mirëqenies.

Pas përfundimit të diskutimeve të zhvilluara nga anëtarët e Komisionit, Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm, miratoi në parim projektligjin “Për buxhetin e vitit 2022”, duke konstatuar se:

- Në aspektin ligjor projektligji është në përputhje me nenet 158 dhe 159 të Kushtetutës;
- Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur dhe po shqyrtohet në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, në përputhje me afatet e përcaktuara Kalendarin e Kuvendit sipas nenit 79 të Rregullores për shqyrtimin e projektligjit të Buxhetit të Shtetit të Vitit 2022, dhe bazuar në nenin 80 të Rregullores së Kuvendit, ia paraqet këtë raport Komisionit për Ekonominë dhe Financat.

RELATORE

Anila DENAJ

Mirela PITUSHI

Orjola PAMPURI

Grida DUMA

KRYETARE

Albana VOKSHI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

KOMISIONI PËR PUNËN, ÇËSHTJET SOCIALE DHE SHËNDETËSINË

Tiranë, më 18. 11. 2022

Dokument parlamentar

(Komision për dhënie mendimi)

RAPORT

PËR PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT 2022” NEN PËR NEN

Drejtuar: *Komisionit përgjegjës për Ekonominë dhe Financat*

Seancës Plenare

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, bazuar në Kalendarin e posaçëm të Kuvendit për shqyrtimin e projektligjit “Për buxhetin e vitit 2022”, në mbledhjet e tij të datës 10, 11 dhe 18 nëntor, shqyrtoi projektligjin “Për buxhetin e vitit 2022”, nen për nen.

Të ftuar për të marrë pjesë në diskutim dhe për t’iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve ishin përfaqësues të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrisë së Shtetit për Rininë dhe Fëmijët.

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë e shqyrtoi këtë projektligj në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, bazuar në nenet 32-39 dhe nenit 80 të Rregullores së Kuvendit.

Gjatë shqyrtimit të projektligjit nen për nen, Ministrinë përkatëse nuk shprehën kërkesa për shtesa në programet e tyre buxhetore.

Komisioni, bazuar në nenin 36 dhe 80 të Rregullores, zhvilloi seanca dëgjimore publike me përfaqësues të ministrive të linjës dhe me përfaqësues të organizatave jofitimprurëse që veprojnë në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve dhe fëmijëve jetimë, organizatave të personave me aftësi të kufizuar, personave që vuajnë nga sëmundja e diabetit, talasemisë, organizatat e

romëve dhe egjiptianëve, sindikatat e pavarura dhe konfederata, ish-të përndjekurit politikë, etj.

Në dëgjesën me drejtues të spitaleve, shefave të shërbimeve u kërkua ndryshimi në ligjin e prokurimeve për blerjet urgjente, sepse shpesh ngurtësia e procedurave sjell vonesa në ilaçe e si rrjedhojë mungesë kurash.

Pasi dëgjoji dhe diskutoi mbi propozimet e bëra nga grupet e interesit, Komisioni ra dakord që t'i rekomandojë Komisionit përgjegjës për Ekonominë dhe Financat, që të vlerësojë mundësinë e shtesave të fondeve në projektbuxhet përkatësisht si më poshtë vijon:

Në programet e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë:

- Rritjen e masës së mbështetjes nga buxheti i shtetit për shoqatën kombëtare të jetimëve në masën 620 mijë lekë për vitin 2022.
- Planifikimin e një fondi për aksesueshmërinë e qendrave ekzistuese për Personat me Aftësi të Kufizuar në përgjithësi dhe para tetraplegjikët në veçanti.
- Alokim i një fondi me vlerë 355.735.000 për shpërblimin e personave me Aftësi të kufizuar (5.000 lekë personi) për festat e fundvitit.

Në programet e Ministrisë së Shëndetësisë:

- Alokimi i një fondi për rimbursim të fishave për matjen e nivelit të sheqerit (glicemisë), për kategorinë e pensionistëve.
- Alokimin e një fondi për bustin e skoliozës dhe trajnim të Ekspertëve për këtë fushë.

Pasi dëgjoji mendimin e përfaqësuesve të Ministrive përkatëse si dhe pas diskutimeve të anëtarëve të tij, Komisioni, me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm, miratoi nen për nen dhe në tërësi projektligjin.

Anëtarët e opozitës u shprehën se mbështesin rekomandimet e bëra nga Komisioni nen për nen, por votojnë kundër projektbuxhetit për vitin 2022 nen për nen dhe në tërësi.

Kryetare

Albana VOKSHI